

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

PËR

METODOLOGJINË E LLOGARITJES SË FONDEVE PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” propozohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrin e Financave. Ky projektvendim është hartuar me qëllimin për të qartësuar procedurat dhe lehtësuar Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore lidhur me aplikimin për të përfituar mbështetje financiare përmes mekanizmit financier të Fondit Social. Projektakti i propozuar është rezultat i një vlerësimi të thelluar paraprak të ndërmarrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me kuadrin ligjor dhe funksionimin e Fondit Social në juridiksonin vendor. Ligji nr.121/2016 krijon vetëm kornizën ligjore për krijimin e Fondit Social, duke ia deleguar Këshillit të Ministrave (KM) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nxjerrjen e akteve nënligjore për ngritjen, funksionimin dhe administrimin e Fondit Social.

Bazuar në Nenin 48/2 të ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” (në vazhdim ligji nr.121/2016), Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr.150/2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror” i cili parashikonte procedurat dhe metodologjinë e financimit të shërbimeve të kujdsit shoqëror nga Fondi Social.

Vlerësimi i zbatimit të këtij vendimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nga viti 2019 deri në 2023, nxori në pah nevojën për të propozuar një akt normative të ri, nisur nga fakti që ndryshimet që parashikohen të bëhen tejkalojnë 60 % të parashikimeve të vendimit aktual.

Ndryshimet konsistojnë në shtimin e qartësisë së tij si edhe lehtësimin e NJVQV lidhur me procedurat e aplikimit, zbatimit dhe monitorimit të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga Fondi Social. Në këtë drejtim, ky projektvendim ka si objektiv të përgjithshëm paraqitjen e ndryshimeve që do të përmirësojnë procesin e aplikimit të NJVQV për të përfituar mbështetje financiare nga pushteti qendror, me qëllim përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror; ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror dhe zhvillimin e politikave sociale në nivel vendor.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.

Në të njëjtën kohë, projektvendimi ka si qëllim të unifikojë formatet e aplikimit dhe raportimit me qëllim lehtësimin e NVQV lidhur me administrimin dhe vjenien në zbatim të mekanizmit finansiar të Fondit Social. Për këtë qëllim, në projektvendim është parashikuar hartimi i udhëzuesit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (bashki/qarqe) lidhur me formatet e aplikimit, kriteret e përzgjedhjes, formati i marrëveshjes me Shërbimin Social Shtetëror si edhe formatet e raportimit për vjenien në zbatim të mekanizmit finansiar të fondit social.

II.VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është rezultat i analizës së thelluar paraprake të kryer nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidur me kuadrin ligjor dhe sfidat e funksionimit të Fondit Social në juridikcion vendor. Si i tillë, ai është propozuar bazuar në rekomandimet e nxjerra në vijim të kësaj analize të thelluar.

Projektakti është planifikuar në Programin të Përgjithshëm Analistik të Projektakteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që do të paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave brenda 4 majorit të parë të vitit 2024.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr.121/2016 i delegon Këshillit të Ministrave (KM) miratimin e metodologjisë së llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Për këtë arsy, u miratua në Mars 2019, Vendimin nr. 150 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”. Përveç metodologjisë së financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, vendimi detajon procedurat për miratimin e planeve sociale në nivel vendor, të cilat do të shërbejnë si reference për përgatitjen e projekt propozimeve nga ana e Bashkive lidhur me kërkesat për financim përmes Fondit Social. Vlerësimi i zbatueshmërisë së këtij vendimi në nivel vendor evidentoi mungesën e rregullave të unifikuara dhe paqartësi në drejtim të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore lidhur me procedurat e aplikimit dhe garantimin e efikasitetit në drejtim të vënies në përdorim të mekanizmit financier të Fondit Social si përsa i përket ngritjes së shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror, ashtu edhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese.

Duke marrë në konsideratë sfidat dhe problematikat me të cilat përballen NJVQV lidhur me përgatitjen e kërkesave për financim nga MSHMS, projektakti i ri i propozuar synon të rrisë shkallën e qartësisë në nivel vendor lidhur me metodologjinë e ndjekur nga pushteti qëndror për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror përmes mekanizmit të Fondit Social.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kuidesit shqiptar”.

Projektakti i ri ka si objektiv të përgjithshëm paraqitjen e ndryshimeve që do të përmirësojnë i-procesin e aplikimit të NJVQV për të përfituar mbështetje financiare nga pushteti qendror, me qëllim përmirësimin e standardeve dhe kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror në respekt të kornizës europiane të standardeve; ii- ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror dhe zhvillimin e politikave sociale në nivel vendor.; iii- zbatimin e parashikimeve ligjore lidhur me rrugën dhe procedurat që ndjekin Bashkitë për të përfituar financim në Fondin Social dhe shmangien e praktikës së financimit përmes thirrjeve; iv- prokurimit të shërbimeve, për rastet kur shërbimi i financuar nga fondi social zbatohet nga vetë bashkia apo nga organizatat joqeveritare partnere, v- aplikime të përbashkëta për shërbime të përbashkëta nga 2 ose më shumën bashki fqinje, vi- zbatimit dhe monitorimit të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror nga Fondi Social, vii- respektimin e kushteve dhe detyrimeve kontraktuale që rrjedhin nga Marrëveshja e lidhur midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Njësisë së Qeverisjes Vendore, në rast të përfitimit nga Fondi Social.

Projektvendimi synon të rishikojë periudhën, në dispozicion të NJVQV lidhur me dorëzimin e kërkeseve për financim, Brenda muajit prill të vitit, me qëllim që Ministria përgjegjëse për eshtjet sociale të parashikojë fondin për vitin e ardhshëm, për produktin “Fondi Social” në Programin Buxhetor “Përkrahja sociale”, bazuar në nevojat e NJVQV (bashki/qark).

Për sa më sipër, projekt vendimi eshtë me rëndësi për të mundësuar funksionimin efektiv të fondit social në nivel vendor duke krijuar një praktikë të unifikuar për të gjitha NJVQV lidhur me procesin e aplikimit për të përfituar mbështetje financiare nga pushteti qëndror për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror që ofrohen në nivel të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi eshtë hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 48, pika 2, të ligjit nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË

Ky projektvendim nuk synon të përafrojë legjislacionin shqiptar me ACQUIS të BE-së. Në këtë kuptim, ndryshimet e propozuara nuk transpozojnë akte të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi eshtë i ndarë në 5 krerë.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.

Në Kreun I Rregulla të përgjithshme, përcaktohet se projektvendimi ka për qëllim hartimin e metodologjisë së llogaritjes së fondeve të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe procedurën që do të ndiqet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Procesi i realizimit të procedurave të financimit nga buxheti i shtetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në nivel vendor kryhet në kuadrin e Fondit Social, përfshirë financimin e shërbimeve të specializuara komunitare, të këshillimit me telefon ose on-line, të ofruara në nivel qarku, sipas përcaktiveve të bëra në pikat 6 e 7, të nenit 3, të ligjit nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”.

Gjithashtu në këtë kre përcaktohet se Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, duke u bazuar në planet sociale vendore, të kostuara dhe në prioritetet kombëtare për shtrirjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror, parashikon në buxhetin e saj, fondin e nevojshëm për financimin e tyre në formën e transfertave të kushtëzuara, në kuadër të programit buxhetor afatmesëm, të cilat i transferohen pushtetit vendor, ku funksionojnë/do të funksionojnë këto shërbime.

Në Kreun II Procedurat e përgjedhjes dhe llogaritjes së financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror përcaktohet se: Drejtoria përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë njësive të vetëqeverisjes vendore mbledh dhe analizon: Të dhënat demografike bazë; Profilin dhe karakteristikat e kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, të ndara sipas gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar, origjinës etnike dhe/ose kategori të tjera në nevojë; Listën e shërbimeve ekzistuese dhe shpërndarjen e tyre në territorin e bashkisë ose në qarkun, ku bën pjesë bashkia përkatëse; Numrin e përfituesve nga shërbimet e kujdesit shoqëror të ndara sipas gjinisë; Financimin e shërbimeve aktuale; Të dhënat për strukturat që mbështesin apo ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror të ngritura në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me ligjin, Të dhëna krahasuese për buxhetin e njësisë të vetëqeverisjes vendore për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe shpërndarja e tij në territor. Nevojat për shërbime shoqërore të munguara në territor.

Pas verifikimit të këtyre të dhënave struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror në njësitë e vetëqeverisjes vendore harton raportin e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror, si dhe planin social vendor për periudhën trivjeçare.

Plani social vendor përfshin qëllimet specifike; objektivat; aktivitetet/ shërbimet e përkujdesit shoqëror, që ofrohen në territor; aktorët përgjegjës/njësitë zbatuese për secilin aktivitet; afatet e zbatimit për çdo shërbim; treguesit që mundësojnë matjen e realizimit me sukses të aktivitetit/shërbimit, referencat ligjore ku e ka bazën aktiviteti specifik i parashikuar, financimin e aktivitetit/shërbimit që specifikon burimin që e mbështet (buxheti i bashkisë/buxheti kombëtar/donorë) metodologjinë e monitorimit dhe njësinë e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të aktivitetit dhe treguesit e matjes së performancës së shërbimeve të kujdesit shoqëror si edhe kostimin/koston për secilin prej aktiviteteve të përfshira në planin social vendor.

Struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror në njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkërendon planet sociale vendore trevjeçare, të njësive administrative në territorin e saj. Kur vlerëson që ekzistojnë kushtet që një apo disa shërbime që përbushin nevojat e dy apo më shumë njësive administrative, kryen përllogaritjen e kostos së aktiviteteve dhe ia paraqet për miratim këshillit bashkiak/të qarkut, pas konsultimit të tij me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Plani social vendor i çdo njësie të vetëqeverisjes vendore përfshin shërbimet shoqërore ekzistuese dhe shërbimet e reja, të kostuara, sipas standardeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.

çështjet sociale, si dhe burimet përkatëse të financimit të tyre. Kostoja e çdo shërbimi indeksohet çdo vit, në bazë të inflacionit zyrtar të llogaritur nga Instituti i Statistikave. Vlera e ndryshuar nga indeksimi mbulohet nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planet sociale vendore, përgatisin kërkesat për financim të Fondit Social, të miratuara nga këshillat bashkiakë/e qarkut, nga buxheti i shtetit i viti të ardhshëm, në kuadër të programit buxhetor afatmesëm, të cilat i dërgohen ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, brenda muajit mars të çdo viti.

Kërkesat për financim në nivel bashkie shtrihen për një periudhë trevjeçare ndërsa kërkesat për financim në nivel qarku nivel shtrihen për një periudhë njëvjeçare. Këto kërkesa hartohen sipas formatit të miratuar nga Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave për Financim dhe përbajnjë të dhëna për qëllimin dhe lidhja me planin social vendor, objektivat specifikë, veprimtaritë, përfituesit e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, të ndarë sipas gjinisë, buxhetin, rezultatet e synuara.

Në rastet të veçanta, për shërbimet që kërkohen të financohen për disa bashki, kërkesa e financimit dërgohet si kërkesë e përbashkët e këtyre bashkive. Kërkesa e përbashkët të jetë e miratuar nga këshillat bashkiakë respektivë e shoqëruar nga marrëveshja e përbashkët midis dy ose më shumë bashkive, ku të përcaktohet në mënyrë të qartë njësia e vetëqeverisjes vendore që do të jetë drejtuese në zbatim të aktiviteteve.

Këshilli i Qarkut miraton kërkesën për financim nga buxheti i shtetit, për ngritjen apo vazhdimësinë shërbimeve në nivel rajonal për vitin pasardhës, të ofruara nga vetë Qarku apo në marrëveshje bashkëpunimi me organizatat joftimprurëse.

Kategoritë e aktiviteteve/shpenzimeve që mbështeten nga Fondi Social, për shërbimet e specializuara në nivel qarku, janë fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore të stafeve sociale dhe rast pas rasti fonde për shpenzime ushqimore për përfituesit, sipas përcaktimeve të legjisacionit në fuqi.

Ngritura, përbërja dhe funksionimi i Komisionit të Vlerësimit të Kërkesave për Financim dhe Sekretariatin Teknik bëhet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale. Ky komisionbazuar në kritëret e vendosura në këtë vendim

Komisioni bazuar në kriteret e vendosura në këtë vendim vlerëson kërkesat e ardhura dhe merr vendim për pranimin ose refuzimin e tyre, brenda muajit korrik të çdo viti dhe merr vendim përfundimtar për miratimin e kërkesave për financim, brenda muajit tetor të çdo viti.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore pas miratimit të listës me propozimet fituese, brenda muajit dhjetor të çdo viti, lidhin marrëveshjen me Shërbimin Social Shtetëror, për financimin e kërkesës së miratuar, duke filluar nga janari i viti të pasardhës, sipas formatit të miratuar nga Komisioni.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.

Gjithashtu në këtë kre përcaktohet se fondi social i alokuar nuk transferohet në programe të tjera apo përdoret për financimin e aktiviteteve të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë vendim. Në të kundërt, njësia e vetëqeverisjes vendore përjashtohet nga vijimi i financimit të shërbimit shoqëror për vitin pasardhës. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbartin në buxhetin e vitit pasardhës mjetet financiare të Fondit Social të papërdorura në vitin fiskal ushtrimor, përjashtuar financimin nga buxheti i shtetit.

Në Kreun III Metodologja e shpërndarjes së fondevë përcaktohen se: Shpërndarja e fondevë buxhetore për financimin e Fondit Social të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore kryhet nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, pas miratimit të kërkesave për propozim, të dërguara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke u bazuar në: kriterin e nevojës më të madhe për shërbime sociale; impaktin dhe prioritetet e çdo njësie të qeverisjes vendore në ofrimin e këtyre shërbimeve sipas planeve përkatëse sociale; mundësitë e financimit nga buxheti i shtetit; shkallën e mbulimit të financimit të fondit social nga burime të tjera nga buxheti i shtetit; qëndrueshmërinë financiare të modelit të financimit të shërbimeve.

Për përcaktimin e kriterit të nevojës më të madhe për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, Ministria përgjegjëse për çështjet sociale bazohet në të dhënët e disponueshme nga vetë institucioni, si dhe nga Instituti i Statistikave, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Shërbimi Social Shtetëror për parametrat e mëposhtëm: Numrin e popullsisë (10%); Shkallën e papunësisë (15%); Numrin e përfituesve të ndihmës ekonomike (15%); Numrin e personave me aftësi të kufizuar (20%); Numrin e kërkesave për strehim social (10%); Numrin e shërbimeve sociale të ofruara (10%); Numrin e përfituesve të shërbimeve sociale të ofruara (10%); Numrin e organizatave që ofrojnë shërbime sociale (5%); si edhe Ofrimin e shërbimeve të reja sipas shportës së miratuar të shërbimeve (5%).

Financimi i shërbimeve të përkujdesjes shoqërore nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Fondit Social, do të mbëshësë propozimet për krijimin e shërbimeve të reja bazuar në planet sociale vendore të miratuar, duke garantuar qëndrueshmërinë e tyre në kohë dhe duke synuar reduktimin gradual të mbështetjës së tyre nga buxheti i shtetit.

Financimi i buxhetit të shtetit do të mbështesë: deri në 90% të kostos për vitin e parë të ofrimit të shërbimeve; deri në 60% të kostos për vitin e dytë të ofrimit të shërbimeve dhe 30% në vitet në vijim, vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve, krijimin e shërbimeve të tjera dhe shtrirjen e tyre në të gjithë territorin e vendit,

Përjashtim bëjnë shërbimet e specializuara komunitare, si dhe shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line”, në nivel qarku. Shërbimet ofrohen nga vetë Qarku dhe/ose organizatat jo-fitimprurëse, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet tyre. Kategoritë e aktiviteteve/shpenzimeve që përjashtohen nga mbështetja financiare janë: Pjesëmarrije në seminare, konferenca, kongrese; Pjesëmarrija në programe studimore afatgjata; Blerja e tokës, ndërtesës dhe zyrave; Investimet; Shpenzimet e nevojshme për rindërtimin apo rehabilitimin; Shpenzimet për shërbimet që janë tashme në zbatim ose përfunduar nëpërmjet marrëveshjeve paraprake me donatorë.

Kreu IV Ofrimi dhe monitorimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror përcakton se:

Shërbimet e përkujdesjes shoqërore, të parashikuara në Vendimin nr.518/2018, të Këshillit të Ministrave, por që nuk mund të ofrohen prej saj, mund të ofrohen nga organizata jofitimprurëse, që operojnë në këtë fushë.

Njësia e vetëqeverisjes vendore harton specifikimet teknike, bazuar në standarde miratuar nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale për kontraktimin e shërbimit të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, në përputhje me rregullat e prokurimit publik, kur ato ofrohen nga ofruesit jopublikë/organizatat jofitimprurëse. Njësia e vetëqeverisjes vendore në përfundim të procesit lidh kontratat me ofruesit jopublikë/organizatat jofitimprurëse fituese.

Ofruesit jopublikë/organizatat jofitimprurëse të kontraktuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbimet e kujdesit shoqëror, si pjesë e kontratës ndërmjet palëve.

Njësia e vetëqeverisjes vendore raporton, çdo katër muaj, pranë Drejtive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, lidhur me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, financuar nga Fondi Social, si edhe monitoron ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas standardeve e treguesve të performancës, të përcaktuara në konratën e lidhur ndërmjet palëve.

Shërbimi Social Shtetëror monitoron zbatimin e standardeve kombëtare nga njësitë e qeverisjes vendore dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit dhe informon ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, si dhe jep rekomandime për njësitë e qeverisë vendore përgjegjëse për vazhdimin apo ndërprerjen e financimit.

Inspektorati që mbulon fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara në nenin 35, të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror, siguron zbatueshmërinë e standardeve të shërbimeve shoqërore të ofruara nga subjektet e kontraktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Po kështu Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, siguron kontrollin financier të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe harton raportin e kontrollit të zbatimit të shërbimeve/aktiviteteve të financaura pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.

Kontrolli financier për zbatimin e shërbimeve/aktiviteteve të financaura pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit, kryhet në përfundim të vitit të parë të zbatimit të marrëveshjes sipas pikës 19 të këtij vendimi dhe në vijim në periudha 2 vjeçare.

Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ngre grupe kontrolli “ad hoc”, në rast ankesash apo dyshimesh për përdorim të të ardhurave nga buxheti i shtetit në mënyrë jo eficent.

Kreun V. Dispozita kalimtare dhe të fundit përcaktohet se deri në miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit social, llogaritja e kostove për shërbime bëhet në bazë të standardeve ekzistuese apo rast pas rasti, nëse për shërbimin nuk ekzistojnë standarde.

Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ngarkohet të udhëzojë njësitë e vetëqeverisjes vendore për aplikimin dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Po në këtë kre parashikohen institucionet që ngarkohen për zbatimin e keteij vendimi si edhe shfuqizimi i Vendimit nr.150/2019 i Këshillit të Ministrave.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHET PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Ministria përgjegjëse për financat, Shërbimi Social Shtetëror, dhe strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKAKTIT

Për hartimin e këtij projektvendimi ka kontribuar Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave.

Projektvendimi është hartuar dhe koordinuar nga MSHMS përmes grupit ndërinstitucional të punës të ngritur me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 502, datë 21.08.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e kuadrit ligjor mbi funksionimin e mekanizmit të fondit social”.

Projektvendimi do të dërgohet për konsultim të brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETOKE

Ky vendim nuk shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit.

PROPOZUESIT

MINISTRI I FINANCAVE

Ervin METE

MINISTRI I SHËNDETËSISË

DITË MBROJTJES SOCIALE
Amane KOÇIU

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për metodologjinë e llogaritjes së forcave përfirancimine e shërbimeve të kujdesit shoqëror”.